


Filip Çakuli

AKA
PYETJE

8SH-32
C 17



TREGIME

8SH-32
C 17
~

Filip
Çakuli

A ka pyetje?

● Tregime humoristike ●



SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

A KA NDONJË PYETJE?

Megjithëse ishte munduar të mbante shënim me hollësi udhëzimet e shefit të tij, Tasi ishte çuditur në fund, kur gjithë-gjithë kishte mbushur vetëm një fletë blloku. Sidoqoftë, kjo fletë blloku që esenca, majaja e raportit të ardhshëm prej 32 faqesh të daktilografuara, aq sa e donte raportin shoku Liko.

Tasi i dinte mirë shijet e shokut Liko. Në atë raport duhej medoemos të ngrinte probleme të reja në sektorin e artit dhe të kulturës, të thoshte ndonjë gjë të re, që nuk e kishte thënë njeri gjer më sot. Shefi i tij në çdo raport kërkonte gjëra të pathëna, që nga mendimet e gjerë të shprehjet, fjalët e rralla dhe ndonjë pro-verb të pakonsumuar.

Tasi është shembulli i përsosur i një nëpunësi. I përpiktë në punë, në veshje, në sjellje, në të folur. I matur në çdo veprim e bisedë. I pastër, i hekurosur, me flokë të krehur anash, *me një kollare të ngushtë sa një gisht, me një buzëqeshje të fshehur e gati të padukshme*. Në fjalorin e tij fjalët më të përdorshme ishin «urdhëro», «si urdhëron». Nuk besoj të ketë njeri tjetër në botë që t'i shqiptojë kaq bukur këto dy fjalë, të dala nga një shpirt plot përgjërime e bindje.

Thirri me urgjencë Maqon, një burrë të shëndoshë, që ngjante më tepër si ngritës peshash. Maqoja, si gjithnjë, u tregua i gatshëm, duke e shprehur kënaqësinë me fërkimin e duarve. Veç Maqos, në këtë takim të shkurtër u thirr edhe drejtori i shkollës së mesme, si dhe një shkrimtar, i cili kishte marrë emër në rreth për diskutime të bukura e prekëse. I famshëm kishte mbetur diskutimi i tij, me të cilin kryetarja e gruas në rreth ua kishte nxjerrë lotët rrëke gjithë të pranishmëve në një takim kombëtar të nënave me shumë fëmijë. Mendorin, në të vërtetë, e çmonin si shkrimtar më shumë në sajë të këtyre raporteve e diskutimeve, sesa për vepra letrare. Veç një libër me tregime, s'mbahej mend t'i qe botuar tjetër gjë, prej vitesh.

— Ju e dini pse u mblodhëm, — iu drejtua Tasi atyre, duke marrë një pamje tepër serioze, sikur po komunikonte ndonjë lajm me rën-

dësi e duke picërruar ata sytë e tij të hirtë.

— S'është nevoja për hyrje të gjata, ne jemi shokë, — foli Mentori. — Të ndajmë sa më shpejt detyrat, se kemi kohë që nuk kemi zënë punë me dorë.

Tasi i ndau shpejt detyrat. Grupi i punës ua nisi me qejf përgatitjeve, duke u shkëputur krejt nga punët e përditshme. Pas një jave raporti ishte gati. Si e përpunoi me kujdes, Tasi ia dha Mendorit për ta daktilografuar me makinën e degës së Lidhjes.

Tasi ia çoi të nesërmen që në mëngjes shefit. Ai, një burrë i gjatë, imponant, që e mbante ndezur dritën e zyrës deri natën vonë, i hodhi një sy të shpejtë, duke e shfletuar deri te faqja e fundit. Këtu u vrenjt, mblodhi vetullat, dhe Tasi, që e parandjeu stuhinë, u mblodh kruspull e gati nuk merrte frymë fare.

— Po unë ju thashë se e dua 32 faqe, mor djalë, — ia hodhi raportin, duke e parë vëngër. Ndërsa ju ma sollët me 24 faqe? Kaq ishte dhe vjet më duket?

— Po, — shqiptoi me zë të përhumbur Tasi.

— E shikon, pra, ç'keni bërë? I njëjti numër faqesh me atë të vitit të kaluar. Kjo do të thotë se ne kemi mbetur në vend numëro. Ku është hapi cilësor që kemi bërë, në krahasim me një vit më parë? Parvjet, në qoftë se mban mend, e kishim raportin me 17 faqe. Vjet e shtuam me shtatë faqe, ndërsa sivjet mendova ta shtoj me

tetë faqe. Kështu, djalosh? Prandaj punoni edhe pak dhe ma sillni plot 32 faqe, as më shumë, as më pak. Dakord? — buzëqeshi ai, duke zbuluar dhëmbët e bardhë, rregullsinë e të cilëve e prishte një vezullim i artë në anën e majtë të gojës.

Kjo buzëqeshje e solli në vete Tasin. Si i çli-ruar nga një barrë e rëndë, lëvizti trupin dhe shpiu krahët. Nuk ishte nevoja të fliste. Shefi kishte besim të madh tek ai, që cilësohej si nëpunësi më i përgatitur dhe që kishte ndërruar katër shefa. Kishte ndërruar edhe katër kostume, qepur me të njëjtat copa e modele, siç e kishin shefat e tij. Tanimë mbante kostum të errët, me cërka të bardha, ashtu siç e kishte edhe shoku Liko.

Thirri përsëri shkrimtarin dhe Maqon dhe bashkarisht shtuan disa faqe të tjera. E shtypën dhe doli 31 faqe.

— Më tepër s'kemi ç'të shtojmë, — tha Tasi.

— Këtij i them raport unë, — u hodh Mendori, duke vërtitur e shfletuar raportin, sikur të kishte në dorë librin e tij të dytë.

— Duhet dhe një faqe, patjetër, — tundi kokën në shenjë pakënaqësie Tasi.

Vranë mendjen se ç'mund të shtonin, por ëhë, nuk po qulloshnin gjë. Tasi i la të iknin dhe me një zell stoik iu fut punës vetë për të plotësuar faqen e tridhjetë e dytë. Shtoi një detyrë për veten: duhej ta organizonte më mirë punën

në drejtim të agjitacionit, duke mbajtur ngritur një grup veprimtarësh. Njëkohësisht ai duhej të kishte më tepër kujdes në përgatitjen e materialeve të sektorit. «Kur ta shikojë shoku Liko kritikën me emër që i kam bërë vetes sime, me siguri që do të qeshë dhe do ta heqë fare.» Ja kështu, mendoi Tasi, edhe helli piqet, edhe mi-shi s'digjet, duke u bërë gati t'ia çonte raportin shefit.

Shoku Liko tha vetëm «hyr» dhe nuk e ngriti kokën nga dosja e hapur mbi tavolinë. Tasi mbeti në këmbë, te dëra, me raportin e shtrënguar në gjoks me të dyja duart, sikur po mbante një fëmijë. E dinte se cilindo që vinte në këtë zyrë, shoku Liko do ta linte të priste njëfarë kohe te dera. Ndërkohë tjetri do të kishte mundësinë t'i hidhte një sy zyrës së madhe e të mobiluar me shije. Tasi nuk kishte ç'të shikonte më, se i mbante mend me sy mbyllur të gjitha mobiljet që mbushnin zyrën. Ja tavolina e gjatë me rimeso arre, rrethuar me karrige gjysmë-kolltukë, veshur me igelit të zi, një dollap druri, punuar me një stil oriental, në të cilin binin në sy libra të shumtë. Një portmanto...

— Hë, mbarove? — e përmendi zëri i njohur dhe i dashur i shefit, i cili, si mbylli dosjen, mbështeti të dyja duart mbi tavolinë, duke ngrehosur trupin dhe kokën.

— Ja ku e keni, — u përkul me respekt Tasi, duke e vendosur në tavolinë me kujdesin më

të madh raportin. Kaq kujdes e vëmendje i kushtoi kësaj ceremonie të shkurtër, sa dukej sikur po vinte aty një arkë me vezë.

Shoku Liko e shfletoi shpejt e shpejt dhe pa faqen e fundit. Buzëqeshi nën hundë dhe fërkoj mjekrën i kënaqur.

— Atëherë, pasnesër, në orën 9, do të mbli-dhemi. A janë lajmëruar të gjithë?

— Janë marrë të gjitha masat, — buzëqeshi Tasi.

Të enjten, në orën e caktuar, në sallën e vogël, ishin ulur në radhën e parë Tasi, drejtori i shtëpisë së kulturës, shkrimtari, një drejtor shkolle. Shumë të ftuar të tjerë nuk kishin ardhur. Tasi vinte e vinte i shqetësuar.

— Vetëm ne hartuesit e raportit qenkemi mbledhur, — u tha ai pjesëtarëve të radhës së parë. Ata përbënin dhe grupin e agjitorëve që mbante afër Tasi.

Pas pak erdhi shoku Liko. Ai gjithnjë kështu vinte nëpër mbledhje, me vonesë, me sa dukej për t'i dhënë rëndësi vetes. Përshëndeti me kokë sallën. Përshëndetja ishte e ftohtë dhe mbeti e ngrirë në ajër, si një perde në mes tij dhe pjesëmarrësve. Tasi po rrinte gatitu.

— Atëherë fillojmë. — Shoku Liko vuri syzet. — Menduam të organizojmë këtë mbledhje të ngushtë me drejtuesit e kulturës në rreth, për të shtruar disa probleme me rëndësi. Ju lutem, të mbani shënime të hollësishme, me qëllim që

këto t'ua bëni të njohura shokëve poshtë.

Pas kësaj hyrjeje ai nisi ta lexonte raportin me një zë të fortë e të lartë e me intonacionin e duhur. Herë pas here ngrinte kokën dhe i hidhte një vështrim të shpejtë sallës. Kënaqej me shokët, që kishin ulur kokat e mbanin shënime.

E me të vërtetë, megjithëse raportin e dinin përmendsh, se e kishin kaluar nëpër duar kushedi sa herë, pjesëmarrësit e radhës së parë mbanin shënime. Shikonin njëri-tjetrin me bisht të syrit sikur bisedonin pa zë: «Këtë pjesë e kam shkruar unë.» Vetëm njëri nuk mbante shënime, shkrimtari.

Shoku Liko e vuri re. E ndërpreu leximin, hoqi syzet dhe ia nguli sytë.

— Po ju? — iu drejtua atij.

— Urdhëroni, — u ngrit menjëherë në këmbë tjetri.

— Pse nuk mbani shënime? Më i mirë se këta shokët e tjerë qenkeni ju? Apo mendoni se i dini të gjitha dhe s'keni ç'të mësoni? Këtu shtrohen detyra e probleme edhe për ju.

— Po unë... — deshi të fliste shkrimtari, po shoku Liko nuk e la të vazhdonte.

— Prandaj mbani shënime e të mos ju tërheq më vërejtjen për këto gjëra.

Shkrimtari, një burrë rreth të dyzetave, me fytyrë serioze e me flokë të ngritur përpjetë si furçë, mbeti i ngrirë në këmbë. Ai e kishte për-

gatitur vetë gjithë raportin dhe kishte redaktuar edhe pjesët që kishin shkruar shokët, kështu që nuk ishte e nevojshme të mbante shënime. Ai i dinte ato që lexoheshin më mirë se kushdo tjetër atje në sallë. Ndaj i bëri përshtypje kjo ndërhyrje dhe vërejtje njëkohësisht. Megjithatë nxori bllokun dhe bëri sikur shkruante.

Shoku Liko ngeci në një fjalë dhe bëri disa herë «për», «pre», «per»...

— Preventivin... — mërmëriti shkrimtari padashur.

Shoku Liko ia nguli sytë rreptë, pastaj vazhdoi leximin:

— Po... duke pasur parasysh, pra, preventivin... Mbani shënim...

Në faqen e fundit iu drejtua Tasi:

— Ndërsa këto detyra e porosi janë për ty, Tasi.

— E di, — foli pa u menduar Tasi.

— Si e ditke? — harkoi vetullat e holla tjetri, duke formuar rrudha në ballin e ngushtë. — Mbaj shënim aty dhe lëri muhabetet!

Dhe tha fjalën «fund» si në përfundim të një filmi. Pastaj zbriti nga katedra dhe u dha dorën pjesëmarrësve.

— Besoj se sot bëmë një punë të mirë, — u tha me të qeshur atyre që e rrethuan. — Raporti kishte mjaft gjëra të reja, hë?

— Shumë, — u përgjigj Tasi në emër të të tjerëve. — Përfituam mjaft!